



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2020:135136

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514821

P.nr.274/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Dega në Leposaviq, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese, Benita Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale kundër të pandehurit: S. M., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 dhe 6 lidhur me par.1 të Kodit Nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.1339/2018 të datës 18.09.2018, jashtë seance, e në mbështetje të nenit 106 par.1, nën par 1.4 të KPRK-së dhe nenit 357 par.1 nën par 1. 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP), më datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1339/2018 e datës 18.09.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

S. M., nga i ati D., e ëma S., e vajzërisë C., i lindur me datë ..., në Mitrovicë me vendbanim në fshatin Zh., komuna L., serb, për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 dhe 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për shkak të arritjes së parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

III. Palët e dëmtuara R. N. dhe J. J., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1339/2018 të datës 18.09.2018, ndaj të pandehurit S. M., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 dhe 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e çështjes, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare përkritazi me afatet e parashkrimit, ka konstatuar se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale për të pandehurin S. M. sa i përket veprës penale të lartcekur.

Sipas aktakuzës, i pandehuri S. M. është akuzuar nën dyshimin se ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 dhe 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën veprë penale sipas KPRK-së është përcaktuar dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se i pandehuri, veprën penale, dyshohet ta ketë kryer me datë 03.10.2015, ndërsa veprimi i fundit është aktakuza e paraqitur nga ana e Prokurorisë me datë 18.09.2018, dhe që nga ajo kohë e deri më tani, kanë kaluar më shumë se pesë vite.

Sipas nenit 106, par.1 nën par 1.4 është përcaktuar se “*ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim*”, ndërsa sipas nenit 107 par.1 “*afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale*”, ndërsa paragrafi 6 i po të njëjtit nen parasheh se “*afati i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një veprë tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme*”.

Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden në këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, konstaton se nuk është paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit të ndjekjes penale, për parashkrim relativ për këtë veprë penale.

Sipas aktakuzës, i pandehuri këtë veprë penale dyshohet ta ketë kryer deri me datë 03.10.2015 ndërsa veprimi i fundit që është ndërmarrë është aktakuza që është ngritur me datë 18.09.2018, e deri me tani ka kaluar më shumë se pesë (5) vite, andaj konstaton se është përfshirë në parashkrim relativ.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nga data 18.09.2018, datë kur është ngritur aktakuza e deri tani me datë 27.03.2024, kanë kaluar më shumë se pesë (5) vite dhe brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale që do të ndërpriste rrjedhën e afatit të përshkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ në bazë të nenit 106 par.1, nën par 1.4 të KPRK-së. Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 18.09.2023, ditë kjo kur janë mbushur pesë (5) vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata, bazuar në verifikimet që janë bërë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me Nr.905/2024 të datës 21.03.2024, , ka vërtetuar se ndaj të pandehurit S. M. përveç kësaj lënde, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është zhvilluar edhe procedurë tjetër dhe atë lënda P.nr.425/2016, e plotfuqishme me datë 07.11.2017, për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor

nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën veprë është paraparë *dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*.

Bazuar në nenin 107, par.6 të KPRK-së, rrjedha e afatit të parashkrimi ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një veprë tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme. Kjo nënkupton se në rastin konkret, vepra për të cilën është shpallur fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm, nuk e ka ndaluar rrjedhën e parashkrimit, pasi që e njëjta është kryer para rrjedhjes së afatit të parashkrimit.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit të lartcekur, ka arrit parashkrimi relativ i ndjekjes penale për këto vepra penale që janë akuzuar, kjo Gjykatë ka marrë aktvendim, e ka hedhur akuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 par. 3 të KPP-së

Andaj, gjykata në bazë të nenit 357 par.1 nën par. 1.3 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Dega në Leposaviq
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.274/18, datë: 27.03.2024

G j y q t a r j a
Benita Berisha

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.